

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË**

MEDITERRANEAN ENERGY HUB

Data 04.03.2025

TABELA E LËNDËS

KREU I. TE PERGJITHSHME	3
NENI 1.1 PËRKUFIZIMET	3
NENI 1.2 ORGANIZIMI	3
NENI 1.3 EMËRTIMI, THEMELUESIT, SELIA.....	3
NENI 1.4 OBJEKTI	4
NENI 1.5 KOHËZGJATJA	4
KREU II. KAPITALI I RREGJISTRUAR.....	4
NENI 2.1 KAPITALI I REGJISTRUAR DHE KONTRIBUTET NE KAPITAL.....	4
NENI 2.2 LLOJET E AKSIONEVE	5
NENI 2.3 REGJISTRIMI I AKSIONEVE.....	5
NENI 2.4 KALIMI I AKSIONEVE	5
NENI 2.5 E DREJTA E PARABLERJES	6
NENI 2.6 ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPTTALIT	7
KREU III. ORGANET E SHOQËRISË	7
NENI 3.1 ORGANET E SHOQLRiSÉ	7
NENI 3.2 KOMPETENCAT E ASAMBLESË DHE VENDIMMARRIA.....	7
NENI 3.3 THIRRJA E ASAMBLESË	8
NENI 3.4 MBLEDHJET E ASAMBLESË	9
NENI 3.5 VOTIMI ME PROKURË.....	9
NENI 3.6 EKSPERTËT KONTABËL TË AUTORIZUAR.....	9
KREU IV. ADMINISTRATORET	9
NENI 4.1 KOMPETENCAT E ADMINISTRATORËVE.....	9
NENI 4.2 EMËRIMI I ADMINISTRATORËVE.....	9
KREU V. KËSHILLI ADMINISTRATIV.....	10
NENI 5.1 KOMPETENCAT E KËSHILLIT ADMINISTRATIV.....	10
NENI 5.2 EMËRIMI I ANËTARËVE TË KËSHILLIT.....	11
NENI 5.3 MBLEDHJEN E KËSHILLIT	12
KREU VI. DIVIDENDËT DHE FITIMET	12
NENI 6.1 DIVIDENDËT	12

KREU VII. PRISHJA E SHOQERISE 12

NENI 7.1 PRISHJA DHE LIKUIDIMI 14

Two handwritten signatures in blue ink are present at the bottom right of the page. The signature on the left is a stylized, cursive 'F' shape with a vertical line extending downwards. The signature on the right is more complex, featuring a large loop and several smaller strokes.

KREU I. TË PËRGJITHSHME

Neni 1.1 Përkufizimet

Fjalët e përdorura në këtë Statut me geina kapitale do të kenë kuptimin si më poshtë:

“Aksionari Themelues” ka kuptimin që i është dhënë te Neni 1.3(b) {Emërtimi, Themeluesit, Selia).

“Aksionari Transferues” ka kuptimin që i është dhënë te Neni 2.5(a) (E Drejta e Parablerjes) i këtij Statuti.

“Asambleja” ka kuptimin që i është dhënë te Neni 3.1(a) (Organen e Shoqërisë) i këtij Statuti.

“Data e Nënshkrimit” është data në të cilën është nënshkruar ky Statut.

“Këshilli” ka kuptimin që i është dhënë te Neni 3.1(b) (Organet e Shoqërisë) i këtij Statuti.

“Ligji” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

“Statuti” është statuti i Shoqërisë.

“Shoqëria” ka kuptimin që i është dhënë te Neni 1.2 (Emërtimi, Themeluesit, Selia) e këtij Statuti.

Neni 1.2 Organizimi

Aksionari Themelues miraton themelin e një shoqërie aksionare me ofertë private, sipas sistemit të administrimit me një nivel drejtimi, në përputhje me Ligjin, për qëllimet dhe brenda fushës së veprimtarisë të përcaktuar nga ky Statut.

Neni 1.3 Emërtimi, Themeluesit, Selia


(a) Emri i shoqërisë është **MEDITERRANEAN ENERGY HUB SHA** (“Shoqëria”).

(b) Aksionaret themelues te Shoqërisë jane:

Z. Klejdi Braka, shtetas shqiptar, lindur më 18.09.1985, në Fier, Shqipëri, mbajtës i leternjoftimi ID me numër personal I50918048P (në vijim “Aksionari Themelues”).

Z. Giorgio Heller, shtetas italian, lindur me 24.10.1966, ne Roma, Itali, mbajtes i pasaportes me nr. YB7729501 (në vijim “Aksionari Themelues”).

(c) Selia e Shoqërisë është në adresën: Rr. M. Gjollesah, Tirana Ring Center, Zyra 5.2, Kati i 5, Tirane.




Neni 1.4 Objekti

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të përfshijë aktivitetet e mëposhtme, por pa u kufizuar në to:

- (i) Tregetim me shumice dhe pakice te naftes bruto dhe te perpunuar, te gazit natyror, nenprodukteve te tjera te lengshme, vajra lubrifikante, import eksport, shpërndarjen, transportin dhe ruajtjen e tyre, për llogari të saj ose për llogari të palëve të treta.
- (ii) Menaxhimi i objekteve të magazinimit të produkteve të naftës, gazit, karburanteve, lubrifikantëve dhe lëndëve të tjera të para të lidhura me energjinë.
- (iii) Marrja, administrimi dhe caktimi i garancive të çdo lloji, duke përfshirë garancitë, letrat e kreditit, letrat kreditore (SBLC), garancitë bankare dhe garancitë e tjera financiare të marra nga blerësit dhe shitësit për qëllime të monetizimit, financimit dhe/ose sigurimit të transaksioneve të blerjes dhe shitjes.
- (iv) Lëshimi i garancive dhe instrumenteve financiare në favor të të tretëve për blerjen e mallrave dhe mallrave, si dhe për mbulimin e operacioneve tregtare dhe financiare.
- (v) Menaxhimi dhe pjesëmarrja në kompani në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, me aftësinë për të krijuar, blerë, mbajtur dhe disponuar aksione në Automjete për Qëllime të Veçanta (SPV) dhe sipërmarrje të përbashkëta që operojnë në sektorë përkatës.
- (vi) Zgjerimi i aktiviteteve në të gjitha mallrat parësore, përfshirë lëndët e para energetike, mineralet, produktet bujqësore, metalet e çmuara dhe industriale dhe mallrat e tjera të tregtuara në nivel ndërkombëtar.
- (vii) Tregimi dhe ndërmjetësimi financier, drejtpërdrejt ose nëpërmjet platformave të njoitura tregtare, në përputhje me rregulloret në fuqi.
- (viii) Blerja, pronësia dhe menaxhimi i aseteve strategjike, duke përfshirë impiantet e rafinimit, platformat logistike, infrastrukturën e transportit, tubacionet, objektet e magazinimit dhe magazinat e lidhura.
- (ix) Shërbimet e konsulencës dhe menaxhimit operacional në logistikën, sigurinë, pajtueshmërinë me rregullat, kontratat ndërkombëtare dhe menaxhimin e rezikut në tregtimin e mallrave.
- (x) Pjesëmarrja në tendera dhe kontrata prokurimi në sektorët e naftës dhe energjisë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
- (xi) Blerja, shitja dhe dhënia me qira e pasurive të paluajtshme dhe infrastrukturës industriale në lidhje me operacionet e biznesit të Kompanisë.

Neni 1.5 Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e Shoqërisë është e pacaktuar.



KREU II. KAPITALI I REGJISTRUAR

Neni 2.1 Kapitali i Regjistruar dhe Kontributet në Kapital

- (a) **Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është 10.000.000 (Dhjete milionë) lekë dhe është i ndarë në 1.000 (njëmijë) aksione të zakonshme.**
- (b) Kontributi i Aksionareve Themelues në kapitalin e Shoqërisë është si më poshtë:

Aksionari Themelues:	Klejdi Braka
Lloji i kontributit:	Para
Numri i aksioneve të zakonshme:	510 (peseqind e dhjete)
Vlera nominale e secilit aksion:	10.000 (Dhjete mijë) lekë
Aksionari Themelues:	Giorgio Heller
Lloji i kontributit:	Para
Numri i aksioneve të zakonshme:	490 (katerqind e nentedhjete)
Vlera nominale e secilit aksion:	10.000 (Dhjete mijë) lekë

- (c) Kontributi në para i aksionareve themelues në kapitalin e regjistruar eshte shlyer 25% para regjistrimit të Shoqërisë.

Neni 2.2 Llojet e Aksioneve


- (a) Aksionet do të janë të zakonshme. Shoqëria gjithashtu mund të emetojë edhe aksione me përparësi, në përputhje me dispozitat e Ligjit.
- (b) Çdo aksion i zakonshëm i jep zotëruesit të tij të drejta vote në raport proporcional me pjesën e kapitalit që përfaqëson aksioni.
- (c) Aksionet me përparësi do të janë pa të drejtë vote. Të drejtat që rrjedhin nga aksionet me përparësi janë:
- E drejta për të shpëmdarë dividend tek zotëruesit e këtyre aksioneve përpara shpëmdarjes së dividendif tek zotëruesit e aksioneve të zakonshme;
 - Të drejtat e përparësisë në rast likuidimi të Shoqërisë.

Neni 2.3 Regjistri i Aksioneve

Administratori është përgjegjës për krijimin dhe funksionimin e regjistrimit të aksioneve, i cili përban: emrin dhe mbiemrin e aksionarit, apo emrin e regjistruar, nëse është person juridik, vlerën nominale të aksionit, adresën e banimit apo zyrën qendrore të aksionarit dhe datën e kryerjes së regjistrimit, në përputhje me Nenin 119 të Ligjit.

Neni 2.4 Kalimi i Aksioneve

- (a) Aksionariet Themelues kane të drejta të pakufizuara të transferojnë aksionet te palët e treta (përshfirë aksionarët e tjera të Shoqërisë) dhe aksionarët e tjera nuk kanë të drejtë parablerje.



- (b) Aksionarët e tjerë të Shoqërisë mund të transferojnë aksionet vetëm me vendimin e Asamblesë, të marrë me shumicë të zakonshme. Për shitjen e aksioneve zbatohet e drejta e parablerjes, sipas parashikimeve të Neni 2.5 (E Drejta e Parablerjes).
- (c) Në çdo rast, aksionari që dëshion të kalojë aksionin/akcionet që zoteron, njoflon Administratorin me shkrim ose nëpërmjet postës elektronike për këtë kalim. Njoftimi përmban numrin e aksioneve që do të kalohen, si dhe të dhënrat identifikuese të personit të cilit do t'i kalohen aksionet.
- (d) Për transferimin e aksioneve te të tretët (përfshirë për aksionarët e tjerë të Shoqërisë përveç Aksionareve Themelues) zbatohet e drejta e parablerjes, sipas rregullimeve të përcaktuara në Neni 2.05 (E Drejta e Parablerjes) të këtij Statuti.
- (e) Në rastet e kalimit të aksionit/aksioneve nëpërmjet trashëgimisë, Asambleja vendos me shumicë të zakonshme nëse do të pranojë si aksionar të ri personin të cilit i ka kaluar aksioni. Nëse Asambleja nuk arrin shumicën e kërkuar për pranimin e aksionarit trashëgimtar, Shoqëria do të kryejë procedurat për anulimin e aksioneve të trashëguara në përputhje me Nenin 186 (2) të Ligjit. Kjo dispozitë nuk zbatohet për Aksionaret Themelues, te cilet mund ti transferojnë aksionet e tyre trashëgimtarëve të tyre pa pasur nevojë për miratimin nga Asambleja.

Neni 2.5 E Drejta e Parablerjes

- (a) Aksionari që dëshiron të shesë aksionin/akcionet që zoteron ("Aksionari Transferues"), duhet t'ia ofrojë atë fillimisht Aksionareve Themelues.
- (b) Aksionari Transferues njofton me shkrim ose nëpërmjet postës elektronike Aksionarin Themelues, për numrin e aksioneve që do të shesë, çmimin e shitjes, si dhe kushtet e tjera kontraktuale për shitjen e aksioneve. Aksionari Themelues përgjigjet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit, për pranimin e propozimit ose refuzimin e tij.
- (c) Nëse Aksionari Themelues nuk përgjigjet brenda afatit të përcakuar në pikën (b) të këtij Neni, propozimi konsiderohet i refuzuar.
- (d) Nëse Aksionari Themelues pranon pjesërisht propozimin për blerjen e aksioneve, pjesa e mbetur e aksioneve do t'u ofrohet aksionarëve të tjerë të Shoqërisë. Dispozitat e parashikuara në Neni 2.05(f) deri në Neni 2.05(j) të këtij Neni janë të zbatueshme edhe për këtë rast.
- (e) Nëse propozimi i paraqitur nga Aksionari Transferues refuzohet nga Aksionari Themelues, Aksionari Transferues ua ofron aksionarëve të tjerë të Shoqërisë blerjen e aksionit, me çmimin dhe kushtet e ofruara fillimisht Aksionarit Themelues. Propozimi u drejtohet të gjithë aksionarëve të Shoqërisë.
- (f) Aksionari/akcionarët përgjigjen brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit, për pranimin e propozimit ose refuzimin e tij.
- (g) Nëse njoftimi për refuzim jepet para përfundimit të afatit të përcaktuar në



paragrafin
(e) të këtij Neni, ky afat konsiderohet i përfiinduar.

(h) Nëse aksionari/aksionarët të cilëve u drejtohet propozimi, nuk përgjigjen brenda afatit të përcakuar në pikën (f) të këtij Neni, propozimi konsiderohet i refuzuar.

(i) Në rast se oferta pranohet nga më shumë se një aksionar, Aksionari Transferues detyrohet t’ia shesë aksionin, aksionarëve që kanë pranuar ofertën, në proporcione me vlerën e aksioneve që ata zotërojnë.

(j) Nëse propozimi nuk pranohet nga asnjë prej aksionarëve, Aksionari Transferues mund t’ia transferojë aksionin palëve të treta, me çmimin dhe kushtet kontraktuale të shitjes të ofruara fillimisht ndaj aksionarëve të tjera të Shoqërisë.

(k) Aksionari Transferues njoflon Administratorin e Shoqërisë për shitjen e aksionit/aksioneve.

Neni 2.6 Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit

(a) Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë në bazë të Neneve 168-172 te Ligjit, me anë të emetimit të aksioneve të reja, zmadhimit kufizuar të kapitalit, zmadhimit të autorizuar të kapitalit ose zmadhimit te kapitalit me aktive të Shoqërisë në bazë të kushteve të përcaktuara në Pjesën V, Titullin V, Krerët II, III, IV dhe V të Ligjit.

(b) Asambleja e Përgjithshme mund të zvogëlojë kapitalin e Shoqërisë nëpërmjet zvogëlimit të vlerës nominale të aksioneve, zvogëlimit të thjeshtëzuar të kapitalit, apo anulimit të aksioneve në bazë të Neneve 181 -186 të Ligjit me kusht që kapitali nuk mund të jetë më i vogël se kapitali i regjistruar i Shoqërisë.

KREU III. ORGANET E SHOQERISË

Neni 3.1 Organet e Shoqërisë

Organet e Shoqërisë janë:

- (a) Asambleja e Përgjithshme (“Asambleja”);
- (b) Këshilli Administrativ (“Këshilli”);
- (c) Administratori/ Administratorët.

Neni 3.2 Kompeteneat e Asamblesë dhe Vendimmarrja

- (a) Asambleja është organi vendimmarrës i Shoqërisë.
- (b) Në rastin e çështjeve, që vendosen me shumicë të zakonshme, Asambleja mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse janë të pranishëm ose të përfaqësuar aksionarët, që zotërojnë më shumë se 40% (dyzet përqind) të aksioneve, me të drejtë



vote.

- (c) Çështjet që vendosen me shumicë të zakonshme janë:
- (i) Përcaktimi i politikave tregtare të përgjithshme të Shoqërisë;
 - (ii) Emërimi dhe shkarkimi i anëtarëve të Këshillit;
 - (iii) Emërimi dhe shkarkimi i ekspertit/ve kontabël të autorizuar dhe likuiduesve;
 - (iv) Përcaktimi i skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat (b) dhe (c);
 - (v) Miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - (vi) Miratimi i negullave proceduriale të mbledhjeve të Asamblesë;
 - (vii) Çdo çështje tjetër që përcaktohet nga Ligji apo nga ky Statut.
- (d) Në rastin e çështjeve, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar në përputhje me Nenin 145 të Ligjit, Asambleja mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse aksionarët, që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të aksioneve me të drejtë vote, apo përfaqësuesit te tyre, marrin pjesë në votim personalisht ose votojnë me shkresë apo me mjete elektronike, sipas parashikimeve të Nenit 142 të Ligjit.
- (e) Parimi i Vendimmarrjes së Përbashkët

Pavarësisht nga përqindja e kapitalit të zotëruar nga secili aksionar, të gjitha vendimet që, sipas këtij Statuti dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", kërkojnë shumicë të kualifikuar ose shumicë të zakonshme të aksionarëve, mund të merren vetëm me marrëveshjen dhe dakordësinë e të dy aksionarëve themelues.

Vendimet e Përfshira

Ky rregull zbatohet për të gjitha çështjet e rëndësishme, përfshirë, por pa u kufizuar në:

- (i) Ndryshimin ose plotësimin e Statutit të Shoqërisë;
 - (ii) Rritjen ose uljen e kapitalit të regjistruar;
 - (iii) Shpërndarjen e dividendëve dhe përfitimeve;
 - (iv) Pranimin e aksionarëve të rinj ose transferimin e aksioneve tek palë të treta;
 - (v) Emërimin ose shkarkimin e administratorëve dhe anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës;
 - (vi) Miratimin e buxhetit dhe planit të biznesit të Shoqërisë;
 - (vii) Vendimin për likuidimin, ristrukturimin ose shpërbërjen e Shoqërisë;
 - (viii) Çdo vendim tjetër që ndikon në strukturën, drejtimin dhe operacionet thelbësore të Shoqërisë.
- (f) Mekanizmi i Vendimmarrjes



Për të gjitha vendimet e përcaktuara në pikën 2 të këtij nenit, Asambleja mund të marrë një vendim të vlefshëm vetëm nëse të dy aksionarët themelues jepin pëlqimin e tyre të shprehur me shkrim.

Në rast të mosdakordësisë, vendimi nuk mund të miratohet, pavarësisht nga shumica e kapitalit të zotëruar nga secili aksionar.

(g) Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Nëse aksionarët nuk arrijnë të bien dakord për një vendim brenda një afati prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga data e parë e diskutimit të çështjes në Asamble, palët do të angazhohen në negociata të detyrueshme për të arritur një marrëveshje të ndërsjellë. Nëse edhe pas negociatave nuk arrihet marrëveshje, çështja do të zgjidhet nga një pajtimtar i pavarur i zgjedhur me marrëveshje nga të dy aksionarët. Nëse aksionarët nuk bien dakord mbi zgjedhjen e pajtimtarit, ai do të caktohet nga një Gjykatë kompetente në Republikën e Shqipërisë.

(h) Çështjet që vendosen me shumicë të kualifikuar janë:

- (i) Ndryshime apo shtesa të Statutit të Shoqërisë;
- (ii) Emërimin dhe revokimin e administratorëve;
- (iii) Miratimin e buxhetit të Shoqërisë;
- (iv) Zmadhimi apo zvogëlimi i kapitalit të regjistruar të Shoqërisë;
- (v) Shpëmdarja e fitimeve vjetore;
- (vi) Riorganizimi, apo prishja e Shoqërisë;
- (vii) Pjesëtimi i aksioneve dhe anulimi i tyre;
- (viii) Ndryshime në të drejtat që lidhen me aksionet e kategorive të veçanta.

Neni 3.3 Thirrja e Asamblesë

(a) Asambleja mblidhet të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga përfundimi i vitit fiskal. Asambleja thirret nga Administratorët, nga anëtarët e Këshillit në rastet e parashikuara në Nenin 136 të Ligjit, apo nga aksionarët që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të kapitalit të regjistruar, sipas Nenit 139 të Ligjit.

(b) Mbledhja e Asamblesë thiiret nëpërmjet një njoftimi të dërguar me postë ose postë elektronike (e-mail) drejtuar çdo aksionari, përfshirë edhe pëfafqësuesin e aksioneve në zotërim të përbashkët.

(c) Njoftimi, së bashku me dokumentacionin përkatës të parashikuar në Nenin 137 të Ligjit, duhet vënë në dispozicion të paktën 21 (njëzet e një) ditë përpëra datës së caktuar për mbledhjen. Në rastin e parashikuar nga Neni 216(3) i Ligjit, njoftimi dhe dokumentacioni përkatës duhen vënë në dispozicion jo më vonë se 1 (një) muaj përpëra datës së caktuar për



mbledhjen.

(d) Nëse Asambleja nuk është thirrur sipas përcaktimeve të Nenit 137 dhe 138 të Ligjit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë aksionarët janë të pranishëm dhe shprehen dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 3.4 Mbledhjet e Asamblesë

(a) Asambleja merr vendime të vlefshme vetëm me arritjen e kuorumit te parashikuar nga Neni 3.02(b) (Kompetencat e Asainblesë dhe Vendimmarja) dhe Neni 3.02(d) (Kompetencat e Asamblesë dhe Vendimmat'rja). Aksionarët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën (conference call), audio ose audio- video.

(b) Asambleja, me propozimin e Aksionarit Themelues dhe me shumicë të thjeshtë cakton Kryetarin e mbledhjes, si dhe një person për të mbajtur procesverbalin e mbledhjen.

(c) Asambleja vendos me votim të hapur, me përjashtim të rasteve kur kërcohët votim i fshehtë, sipas parashikimeve në Ligj.

Neni 3.5 Votimi me Prokurë

(a) Një aksionar mund të përfaqësohet në Asamble bazë të një prokure, nga një aksionar tjeter, apo nga një person i tretë. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë, e cila mund të përfshijë mbledhjet vijuese, por vetëm për të njëjtin rend dite.

(b) Autorizimi me shkrim ose një kopje e noterizuar depozitohet në selinë e Shoqërisë, siç përcaktohet në njoftimin për mbledhjen e Asamblesë.

Neni 3.6 Ekspertët Kontabël të Autorizuar

(a) Asambleja cakton një ose më shumë persona fizikë ose një shoqëri ekspertësh kontabël të autorizuar si ekspeitë kontabël të autorizuar të shoqërisë, në përputhje me shkronjën “ç”, pika 2 e nenit 135 të Ligjit.

(b) Ekspertët kontabël të autorizuar i raportojnë Këshillit për cështjet kryesore që rezultojnë nga kontrolli finansiar dhe në ve9anti, për dobësi të kontrollit të brendshëm në lidhje me procesin e raportimit finansiar.

(c) Z. Gridi Çaça person fizik, me NUIS L916090l0A, regjistruar në QKB më 31.05.2023, me seli në Tiranë, me nr. license profesionale 413, datë 31.05.2019, emërohet si ekspert kontabël i autorizuar, me mandat 3 (tre) vjeçar.

KREU IV. ADMINISTRATORËT

Neni 4.1 Kompetencat e Administratorëve

Administratorët përfaqësojnë Shoqërinë në lidhje me të tretët, marrin vendime për mënyrën e



vëni në zbatim të politikave tregtare, si dhe ushtrojnë çdo kompetencë tjeter të parashikuar në Ligj.

Neni 4.2 Emërimi i Administratorëve

(a) Këshilli Administrativ zgjedh një ose më shumë persona fizikë si Administratorë. Administratori emërohet për një periudhë kohore prej 3 (tre) vitesh, me të drejtë rizgjedhjeje.

(b) Këshilli Administrativ, me vendim të marrë me shumicë të kualifikuar, mund të shkarkojë në çdo kohë Administratorin nga detyra, pa cenuar të drejtat që burojnë nga kontrata e lidhur ndërmjet tij dhe Shoqërisë.

(c) Administratore te Shoqërisë jane:

Z. Klejdi Braka, shtetas shqiptar, lindur më 18.09.1985, në Fier, Shqipëri, mbajtës i leternoftimi ID me numër personal I50918048P.

Z. Giorgio Heller, shtetas italian, lindur me 24.10.1966, ne Roma, Itali, mbajtes i pasaportes me nr. YB7729501.

Neni 4.3 Përfaqësimi dhe Firma e Përbashkët

1. Parimi i Përgjithshëm

Administratorët e Shoqërisë ushtrojnë së bashku të drejtën e përfaqësimit, firmës dhe menaxhimit të Shoqërisë, në përputhje me dispozitat e këtij Statuti dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për shoqëritë tregtare".

2. Firma për Aktet dhe Operacionet e Administrimit të Përditshëm Për të gjitha transaksionet dhe operacionet e administrimit të përditshëm, duke përfshirë pagesat, kontratat dhe marrëveshjet e tjera me vlerë deri në 20.000 (njëzet mijë) euro ose ekuivalentin e tyre në monedhë tjeter, secili Administrator ka të drejtën të veprojë dhe të firmosë në mënyrë të pavarur, duke përfaqësuar Shoqërinë në mënyrë të vlefshme ndaj palëve të treta.
3. Firma e Përbashkët për Aktet dhe Operacionet e Administrimit të Jashtëzakonshëm Për të gjitha transaksionet me vlerë mbi 20.000 (njëzet mijë) euro, si dhe për aktet që përfshijnë:
 - Marrjen përsipër të detyrimeve të jashtëzakonshme nga Shoqëria;
 - Nënshkrimin e kontravave të financimit ose marrëveshjeve të kredisë;
 - Blerjen, shitjen ose dhënien me qira të pasurive të paluajtshme dhe aseteve strategjike;
 - Vendosjen e hipotekave, pengjeve ose garancive në emër të Shoqërisë;
 - Çdo akt tjeter që mund të ndikojë ndjeshëm në pasurinë, menaxhimin ose detyrimet e Shoqërisë;

Kërkohet firma e përbashkët e të dy Administratorëve për të qenë i vlefshëm dhe efektiv ndaj palëve të treta.



4. Pavlefshmëria e Aktit të Kryer në Shkelje të Kësaj Dispozite
Çdo akt ose transaksion i kryer në kundërshtim me dispozitat e këtij nenit do të konsiderohet i pavlefshëm dhe pa efekt ndaj Shoqërisë, përveç nëse ratifikohet shprehimisht nga të dy Administratorët.
5. Delegimi i Kompetencave dhe Prokurat e Posaçme
Administratorët mund të delegojnë kompetencat të caktuara për palë të treta përmes një prokure të posaçme, me kusht që një delegim i tillë të miratohet me firmë të përbashkët dhe të përcaktojë qartë objektin, kohëzgjatjen dhe shumën maksimale të transaksioneve të autorizuara.

KREU V. KËSHILLI AIMINITRATIV

Neni 5.1 Kompetencat e Këshillit Administrativ

- (a) Këshilli ushtron këto kompetenca:
- (i) Të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të Shoqërisë nga Administratorët;
 - (ii) Të përgatisë, me kërkesë të Asamblesë, marrjen e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e Asamblesë;
 - (iii) Të thërrasë mbledhjen e Asamblesë, sa herë vleiësohet e nevojshme për interesat e Shoqërisë;
 - (iv) Të kujdeset që Shoqëria të respektojë ligjin dhe standarde e kontabilitetit;
 - (v) Të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e Shoqërisë;
 - (vi) Të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të kryhen me saktësi nga Administratorët, të cilët i përgatisin dhe nënshkruanë ato dhe ia paraqesin për miratim Këshillit. Këto dokumente duhet të miratoohen e të nënshkruhen nga të gjithë e anëtarët e Këshillit për t'iu paraqitur Asamblesë, së bashku me një raport të Këshillit për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit finanziar;
 - (vii) Të miratojë buxhetin për vitin fiskal pasardhës, të propozuar nga Administratori, si dhe t'ja paraqesë Asamblesë për miratim;
 - (viii) Të sigurojë se auditimi i librave dhe i regjistimeve kontabël të kryhet të paktën 1 (një) herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur e rapporti i auditimit, drejtuar Asamblesë, t'u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të Këshillit. Raporti i Këshillit, përmendur në pikën (vii) më lart, duhet të përmbajë edhe mendimin për reportin e auditimit;

- (ix) Në rastet e parashikuara në pikat 3, 4 e 5 të nenit 136 të Ligjit, të thërrasë menjëheië Asamblenë, për të shqyrtuar nëse Shoqëria duhet të prishet ose përmarrjen e masave të tjera të nevojshme e të përshtatshme.
- (b) Këshilli mund të krijojë komite të posaçme të përbëra nga anëtarët e vet, në përbushje të detyrave të tij, për të përgatitur mbledhjet apo vendimet, ose për të mbikëqyri vënien në zbatim të vendimeve të Këshillit, sidomos ato të lidhura me veprimtarinë e administratorëve, shpërblimin e tyre dhe auditimin e librave e të regjistrimeve kontabël. Secili komitet duhet të pëi'bëhet në shumicën e vet nga anëtarë të pavarur, që nuk janë administratorë. Mbledhjet e komiteteve të posaçme regjistrohen në procesverbal.

Neni 5.2 Emërimi i Anëtarëve të Këshillit

- (a) Asambleja emëron 3 (tre) deri në 21 (njëzet e një) persona fizikë në cilësinë e anëtarëve të Këshillit në përputhje me Nenin 155 (2) të Ligjit. Anëtarët e Këshillit zgjedhin mes tyre, Kryetarin dhe Nënkyetarin e Këshillit.
- (b) Vendimi i Asamblesë për emërimin e anëtarëve të Këshillit merret me shumicë të zakonshme.
- (c) Anëtarët e Këshillit emërohen për një periudhë kohore prej 3 (tre) vitesh, me të drejtë rizgjedhje.
- (d) Anëtarët e Këshillit mund të shkarkohen nga detyra në çdo kohë nga Asambleja, pa cënuar të drejtat që burojnë nga një kontrate pune e lidhur me Shoqërinë. Vendimi mbi shkarkimin merret me shumicë të zakonshme.
- (e) Personat e mëposhtëm emërohen si anëtarë të parë të Këshillit, për një periudhë kohore prej 3 (tre) vitesh:
 - (i) Anetar Ylli Braka, shtetas shqiptar, lindur me 16.06.1958, ne Fier, Shqiperi, mbajtes i leternjoftimit ID me Nr. Personal F80616089B.
 - (ii) Anëtar Viktor Andoni, shtetas shqiptar, lindur me 06.01.1949, ne Tirane, Shqiperi, mbajtes i leternjoftimit ID me Nr. Personal E90106036A.
 - (iii) Anëtar – Marcello Carrieri, shtetas italian, lindur me 21.01.1956, ne Roma, Itali, mbajtes i pasaportes me nr. YC7813332.
 - (iv) Anëtar – Carlo Canal, shtetas italian, lindur me 30.03.1964, ne Monselice, Itali, mbajtes i pasaportes me nr. YB1879966.

Neni 5.3 Mbledhjet e Këshillit

- (a) Mbledhjet e Këshillit do të mbahen të paktën 2 (dy) herë në vit dhe sa herë të jetë e nevojshme për të mbrojtur interesat e Shoqërisë.
- (b) Thirrja e mbledhjes kryhet nga Kryetari 10 (dhjetë) ditë përpëra datës së mbledhjes. Njoftimi dërgohet me shkrim ose nëpërmjet postës elektronike (e-mail) dhe duhet

të përbajë rendin e ditës dhe çdo informacion të cilësuar si të nevojshëm nga Kryetari.

(c) Vendimet e Këshillit merren kur në mbledhje janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve, me shumicën e votave të pjesëmarrësve. Nëse numri i votave është i barabartë, atëherë vota e Kryetarit përcakton vendimmarrjen.

(d) Anëtarët e Këshillit mund të marrin pjesë në mbledhje nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit, përfshirë komunikimin video dhe audio-konferencë.

(e) Zhvillimi i mbledhjeve të Këshillit regjistrohet në një procesverbal, i cili mbahet nga një sekretar i caktuar nga Kryetari. Prosesverbali përmban vendin dhe datën e takimit, emrat e pjesëmariësve, rendin e ditës, një përshkrim për çështjet e diskutuara e vendimet e marra. Parregullsitë për mbajtjen e procesverbalistit nuk kanë si pasojë pavlefshmërinë e vendimeve të mama. Secili anëtar i Këshillit ka të drejtë të marrë një kopje të procesverbalistit.

KREU VI. DIVIDENDËT DHE FITIMET

Neni 6.1 Dividendët

(a) Në përputhje me dispozitat e Ligjit, Shoqëria me shumicë të kualifikuar të votave të Asamblesë mund të deklarojë dividendët, në përputhje me të drejtat përkatëse të aksionaiëve.

(b) Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me aksionet, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhën në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar që përfaqësojnë aksionet për të cilët paguhet dividendi.

KREU VII. PRISHJA E SHOQERISE

Neni 7.1 Prishja dhe Likuidimi

Në rast të likuidimit të Shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e posaçëm të Asamblesë, të marrë me shumicë të kualifikuar mund të shpërndajë në dobi të aksionarëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të Shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes midis aksionarëve ose atyre që zoterojnë aksione të klasave të ndryshme të Shoqërisë.

Aksionaret Themelues nënshkruajne këtë Statut në datën 04.03.2025.


Aksionari Themelues

Klejdi BRAKA


Klejdi BRAKA

Aksionari Themelues

Giorgio HELLER


Giorgio HELLER
Perktheu nga gjuha shqipe ne ate italiane
Monika ZIKO


Monika ZIKO


Suf